

Tiranë, dt. 24.03.2023

**Parashtrimi i argumenteve për marrjen e informacionit sipas ligjit
Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”**

**Drejtuar: Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave
Personale**

Dërgues: Qendra Shqiptare MediaLook, me seli në:

**Lënda: Parashtrimi i argumenteve për marrjen e informacionit nga
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.**

Më dt. 23.03.2023, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka njoftuar përmes adresës elektronike Qendrën Shqiptare MediaLook, në cilësinë e ankuesit, ballafaqimin në seancën dëgjimore me përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas shkresës Nr.342/5 prot., dt.21.03.2023.

Në këtë shkresë, Zyra e Komisionerit, kërkon depozitim me shkrim të pretendimeve të secilës palë. Në vijim paraqesim argumentet dhe pretendimet tona:

a. Parashtrimi i faktit

Qendra Shqiptare MediaLook, me seli në:, përfaqësuar nga Z. Elvin Luku, është një

OJF që ushtron aktivitetin e saj në fushën e gazetarisë hulumtuese.

Qendra po hulumton dhe për lirimin e spektrit të frekuencave DD2 700MHz nga mediat audiovizive, një detyrim ndërkombëtar, afatet e të cilit janë tejkalluar dy herë nga shteti shqiptar, i cili duhet të zhvendos frekuencat e mediave audiovizive nga brezi 700 MHz. Lirimit të këtij brezi i paraprin dëmshpërblimi për operatorët mediatik, në lidhje me investimet e kryera në infrastrukturë në kuadër të procesit të digjitalizimit.

Në përmbushje të misionit tonë, me datë 24.01.2023, Qendra Shqiptare MediaLook, mbështetur në nenin 3 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ka dërguar një kërkesë për informacion me dy pyetje për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si një nga institucionet kryesore në këtë proces. Konkretisht:

Pyetja 1 - Së pari, ju lutem të na vini në dispozicion një kopje të raportit të kostove të përgatitur nga ekspertët e Asistencës Teknike nga EUD për Lirimin e brezit të frekuencave 700 MHz, Digital Divident 2 (DD2).

Pyetja 2 - Së dyti, nisur nga sa më sipër, sa është në total buxheti i parashikuar nga MIE për kompensimin financiar të OSHMA-ve për shkak të migrimit dhe lirim të brezit 700 MHz DD2? Ju lutem, specifikoni jo vetëm totalin por dhe kompensimin për secilin prej operatoreve mediatik.

Pavarësisht tejkalimit të afateve të parashikuara në ligj, MIE nuk iu përgjigj kërkesës për informacion.

Më dt. 10.02.2023, Qendra i drejtohet me një ankim Zyrës së Komisionerit, me nr.342 prot. Pas trajtimit të saj, Zyra e Komisionerit, i dërgon MIE shkresën me nr. 342/1, “*Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, në të cilin kërkon vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Me dt.23.02.2023, pranë zyrave të Qendrës MediaLook ka mbërritur shkresa me nr.1906/1 prot., dt. 21.02.2023, me lëndën "Kthim përgjigje", dërguar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në këtë shkresë autoriteti publik i është përgjigjur vetëm njëherë nga dy pyetjet e drejtuara ku kërkohej informacion (pyetjes së parë), duke vënë në dispozicion vetëm kopje të raportit të eksperteve ndërkombëtare në lidhje me vlerësimin e kostove për lirin e brezit DD2 700 MHz. Ndërsa për pyetjen e dytë nuk është dhënë asnjë informacion. Në këto kushte, duke vlerësuar si të pa plotësuar detyrimin e autoritetit publik MIE, më dt. 23.02.2023, Qendra i drejtohet sërish Zyrës së Komisionerit me vijim të ankimit, e cila i është drejtuar sërish autoritetit publik për përmbushjen e detyrimit.

Më dt. 15.03.2023 në adresën elektronike MIE i përgjigjet ankesës së MediaLook, me pamundësinë për të dhënë një përgjigje me argumentin se informacioni mbrohet nga sekretit tregtar, citojmë: *Sqarojmë se, kompensimi për secilin prej operatorëve mediatik është konfidencial dhe përbën sekret tregtar. Në këto kushte, ndodhemi në rastin e kufizimit të informacionit të kërkuar, kjo në respektim dhe të pikës 1/b të nenit 17 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.*

Në kushtet kur detyrimi i autoritetit publik nuk ishte përmbushur, duke e arsyetuar përgjigjen e MIE si një artificë për të shmangur dhënien e informacionit, Qendra MediaLook, në emailin me dt. 15.03.2023, i drejtohet sërish Zyrës së Komisionerit me kërkesën për vijimin e ankimit.

E ndodhur në këto kushte, Zyra e Komisionerit në shkresën Nr.342/5 prot., dt.21.03.2023, ka njoftuar mbajtjen e një seance dëgjimore dhe kërkon depozitimin me shkrim të pretendimeve të palëve.

b. Argumentet dhe pretendimet e Qendrës Shqiptare MediaLook

Ankesa e Qendrës MediaLook lidhej mbi mungesën e përgjigjes nga MIE për pyetjen e dytë të dërguar në kërkesën për informacion me dt. 24.01.2023, ku kërkojmë:

Nisur nga sa më sipër, sa është në total buxheti i parashikuar nga MIE për kompensimin financiar të OSHMA-ve për shkak të migrimit dhe liritimit të brezit 700 MHz DD2? Ju lutem, specifikoni jo vetëm totalin por dhe kompensimin për secilin prej operatorëve mediatik.

Pra, pyetja bart dy pjesë:

1. Sa është totali i kompensimit financiar i parashikuar nga MIE të gjithë operatorët?
2. Specifikim i dëmshpërblimit financiar për secilin operator.

Autoriteti publik në përgjigje të kësaj ankese, evidenton: Sqarojmë se, kompensimi për secilin prej operatorëve mediatik është konfidencial dhe përbën **sekret tregtar**.

Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, vlera e dëmshpërblimit total dhe specifikimi i mëtejshëm i kësaj vlere sipas operatorëve, pra, paratë e taksapaguesve shqiptarë, të cilat do të lëvrohen nga buxheti i shtetit, për të kompensuar dhe mbuluar keq menaxhimin e spektrit të frekuencave nga një zinxhir institucionesh, përfshi vetë MIE, është sekret tregtar.

Por çfarë është sekreti tregtar?

Në legjislacionin shqiptar “Sekreti tregtar”, parashikohet nga:

a. Neni 18 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në të cilën parashikohet: a. *Sekreti tregtar është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria e mbron në mënyra të përshtatshme, i cili nëse do të përhapej personave të paautorizuar do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.¹*

b. Neni 111/a, i ligjit nr. 96/ 2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947/2008 ‘Për Pronësisë Industriale’.² Në këtë ligj, pika 1 - “Sekreti tregtar” është informacioni që përmbush kërkesat e mëposhtme: a) është sekret në kuptimin që në tërësinë e tij ose për sa i përket konfigurimit të saktë dhe kombinimit të pjesëve përbërëse të tij, nuk është gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë; b) ka vlerë tregtare, sepse është sekret; c) u është nënshtruar hapave të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit, sipas rrethanave, nga personi që zotëron në mënyrë të ligjshme informacionin për të mbajtur sekretin të fshehtë.

Në pikën 2 të po këtij neni, specifikohet se: 2. *Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, me informacion dhe hap të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit do të kuptojmë: a) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni përfshin, ndër të tjera, njohuritë teknike, informacionet për shoqërinë tregtare dhe informacionet teknologjike; b) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni ka vlerë tregtare, ndër të tjera, në ato raste kur përvetësimi,*

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare, Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/04/14/9901>

² Qendra e Botimeve Zyrtare, Ligji nr. 96/ 2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947/2008 ‘Për Pronësisë Industriale’”, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/07/07/96>

përdorimi ose bërja publike e paligjshme e sekretit tregtar ka mundësi të dëmtojë interesat e personit që kontrollon në mënyrë të ligjshme këtë sekret tregtar, duke cenuar potencialin e tij shkencor dhe teknik, interesat financiare të shoqërisë tregtare, pozicionet strategjike ose mundësinë për të konkurruar; c) hapat e arsyeshëm të referuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni mund të përfshijnë përgatitjen e një akti të brendshëm për administrimin e një sekreti tregtar dhe grupin përkatës të personave, që është përgjegjës për administrimin e tij apo masat për mbrojtjen fizike ose virtuale në aksesin e administrimin e sekretit tregtar.

Sa më sipër, informacioni i kërkuar nga Qendra Shqiptare MediaLook, nuk përbën sekret tregtare, për arsye se:

Së pari, në asnjërin prej pyetjeve që i janë drejtuar autoritetit publik, ne nuk kemi kërkuar “*informacione teknike sensitive mbi infrastrukturën e mediave audiovizive, informacione me të dhëna sensitive tregtare mbi kompanitë apo mbi sekretet teknologjike që ata përdorin*”. I vetmi informacion që ne kërkojmë është sa është vlera totale që shteti shqiptar do ti akordojë mediave për dëmshpërblimin financiar në lidhje me lirimimin e brezit të frekuencave DD2 700 MHz dhe të specifikohet si do të ndahet ky total sipas mediave.

Së dyti, asnjë nga pyetjet tona mbi vlerën e dëmshpërblimit që shteti do u japi operatorëve nuk cenon “*potencialin shkencor dhe teknik, interesat financiare të shoqërisë tregtare, pozicionet strategjike ose mundësinë për të konkurruar*”. Madje, mungesa e transparencës për mënyrën e ndarjes dhe mbajtja e fshehtë vlerave totale dhe specifike të dëmshpërblimit për operatorët, ngre dyshime mbi cenimin e parimit të konkurrimit të drejtë çka mund të dëmtojë pozicionet strategjike të secilit prej operatorëve audiovizivë kombëtarë apo privatë në treg. Kjo mungesë transparence e vlerave të dëmshpërblimit do të sillte dëmtim të interesave të secilit operator mediatik kombëtarë.

Së treti, mbajtja e fshehtë vlerës së dëmshpërblimit që operatorët mediatik do të marrin nga buxheti i shtetit, pra nga paratë e taksapaguesve, me artificën se kjo është një sekret tregtar, dëmton drejtpërdrejt interesin publik, pra të qytetarëve shqiptarë si taksapagues, të cilëve iu mohohet e drejta për tu informuar sesi shpenzohen paratë e tyre për të mbuluar një keqmenaxhim sistematik të spektrit të frekuencave, në të cilën kanë përgjegjësi një sërë institucionesh, përfshi MIE-n.

Së katërti, në kuptimin e ligjit, sekretit tregtar mund të jetë një produkt, recetë, plan biznesi, strategji marketingu ose çdo lloj tjetër informacioni sekret që e bën të ndryshme një shoqëri nga një tjetër. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë aspak me diçka të tillë. Madje, duhet evidentuar se Spektri i Frekuencave është një pasuri publike e patjetërsueshme, e cila menaxhohet dhe përdoret për periudha të caktuara kohore, sipas afateve të licencave nga operator të caktuar dhe jo një produkt i këtyre kompanive. Për këtë arsye, cdo përpjekje e MIE për të refuzuar dhënien e vlerave të dëmshpërblimit për keqmenaxhimin e kësaj pasurie publike, e kompromenton akoma më tej këtë institucion.

Së pesti, ky është dëmshpërblimi i dytë që akordohet nga shteti shqiptar për dëmshpërblimin e operatorëve mediatik në lidhje me lirimin e spektrit të frekuencave. Nëse do të përbënte sekret tregtar, atëherë përse autoritetet/agjencitë publike kanë publikuar dëmshpërblimet për secilin operator në lidhje me spektrin e frekuencave DD1 në vitin 2019?

Së gjashti, vetë ligji Ligji nr. 96/ 2021 “Për Pronësisë Industriale”, në nenin 111/b, pika 2/a, parashikon që: *Rregullat e përcaktuara në pjesën II/a të këtij ligji kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar nuk cenojnë: a) ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit, duke përfshirë respektimin e lirisë dhe të pluralizmit të medias, sipas legjislacionit në fuqi.*

Përmes kësaj pike, ligjvënësit kanë dashur të parandalojnë pikërisht abuzimin dhe përdorimin e “sekretit tregtar” si artificë për të cenuar të drejtën e informimit sikurse po bën MIE dhe fshehjen e informacionit që përmban interes publik.

Sa më sipër, Qendra Shqiptare MediaLook vlerëson se refuzimi i informacionit me argumentin se ai “është sekret tregtar” jo vetëm që nuk qëndron, por e konsiderojmë një përpjekje të vazhdueshme të këtij institucioni për të zvarritur publikimin e hulumtimit tone prej 60 ditësh tashmë, prej dt 24 Janar 2023 kur është dorëzuar kërkesa.

Për këtë arsye, i kërkojmë Zyrës së Komisionerit, që në përputhje me legjislacionin në fuqi të marrë masa dhe të na mundësojë vënien sa më parë në dispozicion të këtij informacioni.

Duke ju falenderuar për kohën tuaj,

Elvin Luku
Drejtues i Qendrës Shqiptare MediaLook